



## NJOFTIM PËR SHTYP

Në vitin 20205, humbjet e ujit në nivel nacional janë 63,05% dhe janë ulur për 0,16% në krahasim me vitin 2024 - tregojnë të dhënat e Raportit Vjetor të Punës së Komisionit Rregullator të Energjetikës, të Shërbimeve të Ujit dhe të Shërbimeve të Menaxhimit me Mbeturina Komunale (KRrE) për vitin 2025.

Ulje prej 0,33 m<sup>3</sup> vërehet te konsumi mesatar mujor i ujit tek amvisëritë, i cili në vitin 2025 ishte 12,59 m<sup>3</sup>. Amvisëritë në rajonin jugperëndimor kanë konsum mesatar më të ulët prej 8,67 m<sup>3</sup>, ndërsa në rajonin e Vardarit konsumi është më i madh me 15,10 m<sup>3</sup>.

Sasia e faturuar e ujit në vitin 2025 është 36,95% dhe është praktikisht në të njëjtin nivel me vitin paraprak (36,79%) .

Përqindje më të lartë të ujit që nuk sjell të hyra ka në rajonin jugperëndimor prej 73,00%, ndërsa përqindje më e ulët e ujit pa të ardhura është regjistruar në rajonin juglindor me 47,88%.

Përqindja e mbulimit me furnizim me ujë në të gjitha rajonet në krahasim me vitin 2024, me ç'rast mbulim më të madh ka në rajonin lindor me 92,58%, ndërsa rritja më e madhe e përqindjes së mbulimit me ujë për një vit ka tejkualuar 3% dhe është regjistruar në rajonin juglindor dhe është 87,50%. Bëhet fjalë për zgjerimin e rrjetit përmes investimeve të reja, por ndikim në zgjerimin e mbulimit me furnizim me ujë ka edhe trendi i lidhjes së sistemeve të vogla të furnizimit me ujë nga mjediset rurale dhe bashkimi i tyre në rrjetin e madh të qytetit.

Në vitin 2025, KRrE-ja ka sjellë 34 aktvendime për përcaktimin e tarifave (kufirin) e furnizimit me ujë të pijshëm, të cilat pastaj i miraton këshilli i komunave përkatëse dhe 9 tarifa finale rregullatore, që janë të detyrueshme për zbatim dhe janë sjellë pasi këshilli nuk e ka pranuar kufirin e propozuar të çmimeve.

20.5.2026



ул. Македонија бр. 25, палата Лазар Поп-Трајков - 6<sup>тм</sup> спрат • 1000 Скопје,  
Република Северна Македонија  
Централа 02 3233-580 • Факс: 02 2556 004 • [www.erc.org.mk](http://www.erc.org.mk) • e-mail: [erc@erc.org.mk](mailto:erc@erc.org.mk)

Rr. Maqedonia nr. 25, pallati L Lazar Pop-Trajkov – kati i 6 • 1000 Shkup,  
Republika e Maqedonisë së Veriut  
Qendra 02 3233-580 • Faks: 02 2556 004 • [www.erc.org.mk](http://www.erc.org.mk) • e-mail: [erc@erc.org.mk](mailto:erc@erc.org.mk)